



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS  
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.377/2013

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, (e vendosur në objektin e degës së kësaj gjykate në Vushtrri) si kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Faton Ademi, ne qështjen juridike të paditëses:

nga të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. kundër të paditurës: Komuna e -Drejtoria për Arsim e Kulturë të cilën e përfaqëson avokati

për pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagesës përcjellëse pas pensionimit, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 15.05.2014 me prezencën e palëve ndërgjyqëse, me datën: 19.05.2014 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** kërkesëpadia e paditëses nga kundër të paditurës Komuna e - Drejtoria Komunale për Arsim, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagës përcjellëse si e **PA BAZUAR**.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t I m**

Paditësi me datën: 24.05.2013 ka parashtruar padi në gjykatë kundër të paditurës për pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagesës përcjellëse pas pensionimit.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: se kërkesëpadia mbështet përveq në normat e kontratës kolektive edhe në kontratën kolektive të punësuarve në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë neni 50 dhe 51 si dhe Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm nr.2002/02, gjithashtu sipas rregullores 2001/27 e njëjta nuk gjen aplikim për të punësuarit në arsim, ndërsa kontratat e përgjithshme kolektive nuk kanë përcaktuar ndonjë afat për të cilin do të pushonë së vepruari, por edhe në supozimin se kjo kontratë do të kishte

*Chapman të pabotues*

vlefshmërinë e saj vetëm për tri vite, këtë të drejtë paditësi duhet ta realizoi bazuar në nenin 34 të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, lidhur me nenin 22 paragrafi 2 pika 3 dhe 5 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civil.

Avokati i ne seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: e kundërshtoj ne tersi padinë dhe kërkesëpadinë pasi qe e njëjta nuk gjen mbështetje në dispozita ligjore e as ne kontratën kolektive, për shkak se kontrata kolektive nuk është ne fuqi e po ashtu nuk ka qen edhe ne kohen kur paditësja ka dal ne pension.

I autorizuari i paditëses ne fjalën përfundimtare deklaroi: Ne tersi pran padis dhe kërkesëpadisë, si dhe thënieve te cekura me larte.

Avokati publik komunal ne fjalën përfundimtare deklaroi: Ne tërësi si ne thëniet e më hershme.

Gjykata ne shqyrtimin kryesor i administroi këto prova: vendimi mbi njohjen e të drejtës mbi pension bazë dhe kontributiv i dt.15.01.2013, përgjigjja ne ankesë e dt.11.02.2013.

Pas analizimit dhe çmuarjes se provave te cekura një nga një dhe te gjitha se bashku si dhe rezultatit te krejt procedurës , ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 te LPK, gjykata vlerësoi se ne mes te palëve procedurale nuk janë kontestuese këto fakte:

Se paditësi ka qenë në marëdhanie pune te e paditura pasi një gjë e tillë vërtetohet nga përgjigja në ankesë e dt.11.02.2013.

Se paditëses marëdhënia e punës i është pushuar me arritjen e moshës së pleqërisë moshës 65 vjeqare, pasi një gjë e tillë vërtetohet nga vendimi mbi njohjen e të drejtës në pension bazë dhe kontributiv.

Këto janë faktet e provuara me prova e të cilat nuk janë kontestuese për palët ndërgjyqëse. Kontestuese mbetet qështja e pagesës së: pageses përcjellëse dhe shpërblimi jubilar.

Paditesja të drejtën e vetë e kërkon duke u mbështetur në kontratën e përgjithshme kolektive, në kontratën kolektivive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm, në Ligjin për Arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe në Ligjin për Pagat e Nëpunësve civil.

Sa i përket Kontratës së Përgjithshme kolektive e njëjta nuk është në fuqi sepse me nenin 90 paragrafi 4 decidivisht përcakton periudhën maksimale 3 vjeqare për lidhjen dhe vlefshmërinë e kësaj kontrate. Kjo kontratë ka hyrë në fuqi në janar 2005 dhe nga janari 2008 nuk është më në fuqi dhe nuk prodhon efekt juridik.

Është e vërtet se rregullorja nr.2001/27 nuk aplikohet në rastin konkret sepse me hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës kjo rregullore pushon së vepruari.

Punëtorët e arsimit që nga data: 13.05.2010 kur ka hyrë në fuqi Ligji Për Shërbimin Civil të republikës së Kosovës, nuk trajtohen më si nëpunës civil, krejt kjo sipas nenit 4 pika 1 të këtij ligji ku thuhet: " Në bazë të këtij ligji statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor " etj. Më herët janë trajtuar si nëpunës apo shërbyes civil edhe punëtorët e arsimit mirëpo tani e tuje nuk mund të trajtohen e as të thirren në të drejta në këtë ligj apo në ligje tjera.

Sa i përket qështjes së Ligjit për pagat e nëpunësve civil në të cilën thirret i autorizuari i paditësit, i njëjti ligj në nenin 1 përcakton qartë se kush mund të përfitoj nga ky ligj, pra kategorinë dhe ky ligj në mënyrë të drejtëpërdrejt të referon në ligjin bazik atë për Shërbyesit civil të cituar më lartë: "Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, sipas përkufizimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se paditësi nuk mund të thirret në Ligjin për pagat e Nëpunësve civil, pasi nuk e ka statusin e shërbyesit civil apo nëpunësit civil sipas ligjit bazik për shërbyesit civil.

Sa i përket qështjes së Ligjit nr.2002/02 ky ligj në asnjë nen nuk përmend qështjen e pagesës jubilarë apo përcjellëse ndërsa në nenin 34 përmend pikërisht kontratën kolektive e cila nuk është në fuqi.

Gjykata nuk është në dijeni se është në fuqi ndonjë kontratë tjetër kolektive për punëtorët e arsimit fillor dhe të mesëm ndërsa në web faqen e Sindikatës e Bashkuar të Arsimit Shkencës dhe Kulturës figuron një propozim i kontratës kolektive i cili nuk ka hyrë në fuqi pasi nuk është nënshkruar nga zyrtarët kompetent, ndërsa kjo kontratë ka gjithsejt 41 nene.

Andaj duke u bazuar në të lartë cekurat bazen ligjore të theksuar me lartë interpretimin e saj nga ana e gjykatës, arrijmë në përfundim se kërkespadia e paditësit duhet të refuzohet në tërësi si e PA BAZUAR.

Me sa u tha me lartë e ne baze te nenit 143 te LPK, u vendos si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.377/2013 Datë: 19.05.2014

GJYQTARI

Faton Ademi



20.08  
KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat prej 7 ditësh nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate

